



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 537/1 Prot.

Tiranë, më 24.03.2023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1915, datë 12.07.2021.

SHOQËRISË “KRAS 2018” SH.P.K
Rruga e Kavajës, Qendra e biznesit “Gurten”, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “KRAS 2018” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1915, datë 12.07.2021, për mineralin gëlqeror pllakor, në Objektin “Krahës”, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.266, datë 13.01.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.537, Prot, datë 17.01.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1915, datë 12.07.2021, për mineralin gëlqeror pllakor, në Objektin “Krahës”, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, ku nga kontrolli në objekt u konstatua se subjekti nuk ka zhvilluar aktivitet minerar për më shumë se 180 ditë kalendarike, nuk ka paguar faturën e garancisë së rehabilitimit të mjedisit për vitin 2022-2023 dhe nuk ka miratuar planin vjetor të punës për periudhën kohore 12.07.2022-12.07.2023.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “b” (ii) dhe pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1915, datë 12.07.2021, për mineralin gëlqeror pllakor, në Objektin “Krahës”, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë

sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1915, datë 12.07.2021, për mineralin gëlqeror pllakor, në Objektin “Krahës”, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

